AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Shkurt 2024

14.03.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin shkurt 2024.

Deficit tregtar më i lartë për 25,2% në muajin shkurt 2024, krahasuar me muajin shkurt 2023

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 25,2% në muajin shkurt 2024, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2023, gjegjësisht në vlerë prej 397,4 milion Euro, krahasuar me deficitin prej 317,5 milion Euro në vitin 2023. Eksporti mbulon importin me 15,0%.

Eksporti i mallrave në muajin shkurt 2024 kishte vlerën 70,3 milion Euro, ndërsa importi 467,8 milion Euro, që është një rënie prej (-3,9%) për eksport, si dhe një rritje prej 19,7% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme



Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 27,9% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 15,4% e përbëjnë artikuj të ndryshëm të prodhuar; 14,5% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 9,3% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 5,5% e përbëjnë makineria dhe pajisjet mekanike dhe elektrike, etj.

Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 15,6% e përbëjnë produktet minerale; 11,8% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,8% e përbëjnë mjetet e transportit; 10,2% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9,9% e përbëjnë makineria dhe pajisjet mekanike dhe elektrike,etj.

Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe %

(në mijë Euro)

Vendet	Shkurt - 2023		Shkurt - 2024	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	**73 170**	**100,0**	**70 317**	**100,0**
27 vendet e BE_së	23 535	32,2	21 867	31,1
Cefta	27 273	37,3	28 608	40,7
Të tjera	22 362	30,6	19 842	28,2
	Importet (CIF)			
Gjithsej	**390 688**	**100,0**	**467 758**	**100,0**
27 vendet e BE_së	173 166	44,3	217 431	46,5
Cefta	61 738	15,8	76 483	16,4
Të tjera	155 784	40	173 844	37,2

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 21,9 milion Euro, ose rreth 31,1% e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej (-7,1%). Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (11,4%), Italia (4,5%), Holanda (2,5%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 217,4 milion Euro, ose 46,5% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 25,6%. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (14,2%), Greqia (5,2%), Italia (4,5%), etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 28,6 milion Euro, ose 40,7% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 4.9%. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (15,2%), Shqipëria (13,8%), Serbia (6,2%), Mali i Zi (4,0%).

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 76,5 milion Euro, ose 16,4% të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 23,9%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (7,9%), Maqedonia e Veriut (5,5%), Serbia (1,8%).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 19,8 milion Euro, ose 28,2%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: SHBA (9,6%) dhe Zvicra (8,2%).

Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 173,8 milion Euro, ose 37,2%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (14,4%) dhe Kina (9,5%).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin shkurt 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ForeignTrade